Vendim nr. 82, datë 17.09.2026

(V- 82/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.09.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (I) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **IRFAN *alias* STEFAN SULAJ,** përfaqësuar nga avokati Vladimir Meçi me akt përfaqësimi.
DËFRIM *alias* AFRIM ÇELA *alias* ÇELAJ

SUBJEKT I INTERESUAR:
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurori Vladimir Mara.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 62, datë 27.10.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 26 (87-2023-103), datë 17.05.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1003, datë 12.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim pranë gjykatës kompetente.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 18, 30, 33, 42, pika 2, 43, 122, pika 2, 124, 131, pika 1, shkronja "f", 132, 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 142, pika 1, dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; nenet 27, 38, 49, pika 3, shkronja "e", 71, 71/a, 71/c dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese**

të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve Irfan *alias* Stefan Sulaj (*kërkuesi i parë*) dhe Dëfrim *alias* Afrim Çela *alias* Çelaj (*kërkuesi i dytë*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Autoritetet policore kanë referuar se në vitin 2016 janë krijuar dy grupe kriminale, të cilat kanë pasur për qëllim trafikimin e lëndës narkotike, kryesisht të llojit "heroinë", nga Shqipëria në drejtim të Greqisë. Të paktën në 3 raste (episodet e datave 25.05.2016, 12.06.2016 dhe 10.12.2016), veprimtaria e trafikimit të lëndëve narkotike është drejtuar nga dy kërkuesit dhe një person i tretë, të cilët kanë bashkëpunuar edhe me persona të tjerë në Shqipëri dhe në Greqi. Lidhur me këto tre episode, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin e datës 18.05.2016, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a, paragrafi 2, i Kodit Penal (*KP*).

2. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, prokuroria ka urdhëruar regjistrimin e emrave të dy kërkuesve dhe të disa shtetasve për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Trafikimi i narkotikëve" dhe "Grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 283, 283/a dhe 333/a, paragrafi 2, të KP-së.

3. Bashkëpunëtorët e tjerë janë proceduar penalisht veçmas nga dy kërkuesit. Njëri prej bashkëpunëtorëve, me vendimin nr. 115, datë 30.11.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është deklaruar fajtor për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi 1 dhe 22 të KP-së, që lidhej me episodin e datës 12.06.2016. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 34, datë 07.05.2019. Ndërsa një bashkëpunëtor tjetër, me vendimin nr. 27, datë 15.03.2018, të së njëjtës gjykatë, është deklaruar fajtor për veprën penale të trafikimit të narkotikëve në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi 2 dhe 22, të KP-së, që lidhej me episodin e datës 10.12.2016. Edhe ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 54, datë 15.05.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

4. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, procedimi penal në ngarkim të dy kërkuesve është transferuar pranë saj dhe është regjistruar me nr. 15, viti 2019. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme ka arritur në përfundimin se kërkuesit, në bashkëpunim me persona të tjerë, kanë qenë pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike, në rolin e drejtuesve për organizimin e gjetjes dhe transportimit të lëndës narkotike për realizimin e përfitimeve materiale.

5. Në datën 09.11.2021 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, duke akuzuar kërkuesin e parë për veprat penale të trafikimit të narkotikëve, të kryer më shumë se një herë (në tre episode, dy prej të cilave të mbetura në tentativë), drejtimit të grupit të strukturuar kriminal, kryerjes së veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal, prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe drejtimit të automjetit nën efektin e lëndëve narkotike, të parashikuara nga nenet 283/a, paragrafi i dytë e 28, paragrafi i katërt, 333/a, paragrafi i parë, 334, paragrafi i parë, 283, paragrafi i parë, dhe 291 të KP-së. Kërkuesi i dytë është akuzuar për veprat penale të trafikimit të narkotikëve, të kryer më shumë se një herë (në tre episode, dy prej të cilave të mbetura në tentativë), drejtimit të grupit të strukturuar kriminal dhe kryerjes së veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 283/a, paragrafi i dytë e 28, paragrafi i katërt, 333/a, paragrafi i parë, dhe 334, paragrafi i parë, të KP-së.

6. Gjyqtari i seancës paraprake, me vendimin e datës 20.01.2022, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq për të dy kërkuesit, sipas akuzave të ngritura, së bashku me kërkesën e tyre për gjykim të shkurtuar. Në gjykimin në shkallën e parë, pasi ka konfirmuar sërish vullnetin e kërkuesve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka vendosur zhvillimin e procesit me gjykim të shkurtuar.

7. Në përfundim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 62, datë 27.10.2022, ka vendosur deklarimin fajtorë të kërkuesve sipas akuzave, duke dënuar përkatësisht kërkuesin e parë me 12 vjet burgim, ndërsa kërkuesin e dytë me 10 vjet burgim. Gjykata ka argumentuar se në rastin konkret bashkëpunimi ka qenë i strukturuar, ku kërkuesit mbanin rolin e drejtuesve të grupit kriminal për të organizuar gjetjen dhe transportimin e lëndës narkotike. Po kështu, në momentin e ndalimit kërkuesi i parë ka qenë duke drejtuar automjetin e tij nën ndikimin e heroinës dhe se nuk plotësoheshin kushtet ligjore për uljen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji ose për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

8. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi, me të njëjtën linjë arsyetimi, nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 26 (87-2023-103), datë 17.05.2023. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1003, datë 12.06.2025, ka vendosur

mospranimin e rekurseve të tyre, si të pabazuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

9. Në datën 09.10.2025 kërkuesi i parë është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 23.10.2025. Me vendimin e datës 29.12.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 16.01.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

10. Rreth 2 muaj më vonë, në datën 12.12.2025, edhe kërkuesi i dytë ka paraqitur ankim kushtetues individual, i cili është regjistruar në datën 12.12.2025. Në datën 16.02.2026 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

11. Pas kalimit të çështjeve në seancë plenare, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 09.06.2026, ka vendosur bashkimin e tyre në një të vetme, pasi ka vlerësuar se të dy kërkuesit janë akuzuar dhe dënuar në të njëjtin proces penal dhe se, në thelb, kanë parashtruar pretendime kushtetuese të njëjta.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi i parë***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

12.1. *E drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit thelbësor që lidhej me cilësimin e gabuar juridik të veprave penale. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar përse shkaqet e rekursit nuk përfshihen në ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së ose përse nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore.

12.2. *E drejta e mbrojtjes,* pasi gjatë hetimeve paraprake as atij, as mbrojtësit nuk u janë njoftuar vendimet për zgjatjen e afateve hetimore, duke pamundësuar kontrollin gjyqësor të tyre.

12.3. *Parimi i ligjshmërisë dhe i proporcionalitetit të dënimit penal,* pasi gjykatat e zakonshme kanë dhënë vendim dënimi për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i KP-së pa kryer ekspertimin mjeko-ligjor mbi "*gjendjen nën efekt*" gjatë drejtimit të mjetit, duke e bërë gjykimin të paparashikueshëm. Edhe për akuzën e parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë, i KP-së ka munguar ekspertimi i sasisë së lëndës narkotike për të përcaktuar nëse ajo ishte apo jo dozë e vogël për

përdorim vetjak, ndaj dënimi ka qenë arbitrar. Gjykatat e zakonshme në caktimin e dënimit nuk kanë vlerësuar realisht rrethanat lehtësuese të parashikuara nga ligji penal.

12.4. *Parimi i sigurisë juridike dhe i barazisë para ligjit*, pasi kërkuesi është dënuar për grup të strukturuar kriminal për të njëjtat episode kriminale, për të cilat dy bashkëpunëtorë të tjerë janë dënuar për bashkëpunim të thjeshtë.

13. ***Kërkuesi i dytë***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

13.1. *E drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë ka shmangur shqyrtimin e shkaqeve të rekursit, duke u mbështetur në argumente kontradiktore. Nga njëra anë, Gjykata e Lartë ka theksuar se pretendimet në rekurs lidhen me shkeljen procedurale të cilësimit juridik të veprave penale dhe, nga ana tjetër, arrin në përfundimin që pretendimet lidhen me provat. Shkeljet procedurale që lidhen me njoftimin e zgjatjes së afatit të hetimeve dhe me bashkimin e dënimeve nuk kanë marrë përgjigje të plotë në asnjë shkallë të gjykimit.

13.2. *E drejta e mbrojtjes,* pasi Prokuroria e Posaçme ka tejkaluar afatet e hetimit, ndërsa vendimet për zgjatjen e afateve, në shkelje të ligjit, në asnjë rast nuk i janë njoftuar kërkuesit, ndaj ato vendime dhe aktet pasuese të tyre janë absolutisht të pavlefshme. Gjykatat e faktit e kanë konstatuar këtë shkelje, por në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë nuk kanë reflektuar për ta riparuar atë.

13.3. *Parimi i sigurisë juridike dhe i barazisë para ligjit,* pasi gjykatat e zakonshme kanë zbatuar standarde të ndryshme në përcaktimin e formës së bashkëpunimit, lidhur me të njëjtat episode të të njëjtit aktivitet kriminal. Kërkuesi është dënuar për bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, ndërsa dy shtetas të tjerë, me vendime gjyqësore përfundimtare në vitin 2017 dhe 2018, janë dënuar për bashkëpunim të thjeshtë.

14. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

14.1. Pretendimi për cenimin e së *drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me legjitimitetin, përmbushjen e kritereve ligjore dhe faktet e çështjes. Ndonëse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve, ajo ka marrë në shqyrtim, ka analizuar dhe u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurse. Po kështu, ajo ka verifikuar dhe

vlerësuar shkaqet procedurale dhe ka mbështetur argumentet e dhëna nga gjykatat e posaçme.

14.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të dënimit* nuk qëndron, pasi mungesa e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor për përcaktimin e sasisë së lëndës narkotike është çmuar nga gjykatat në raport me tërësinë e provave të administruara. Gjykatat kanë vlerësuar se kjo mungesë nuk e përjashton kërkuesin nga përgjegjësia penale, pasi provat e mbledhura dhe sjellja e tij kanë konfirmuar natyrën e lëndës narkotike, mënyrën e mbajtjes së saj dhe tentativën për ta fshehur gjatë shoqërimit.

14.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes* është i pabazuar, pasi gjykatat kanë arsyetuar me prova se kërkuesit së bashku ishin drejtues të grupit të strukturuar kriminal. Hetimet ndaj kërkuesve kanë përfunduar brenda afatit maksimal 2-vjeçar të parashikuar në pikën 2 të nenit 324 të KPP-së. Mosnjoftimi i vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit nuk ka pasojë mbi vlefshmërinë e akteve ose përdorshmërinë e provave dhe nuk rezulton të ketë penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes ose të ketë krijuar ndonjë disavantazh procedural për kërkuesit. Ata kanë pasur mundësinë të ushtrojnë të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara nga ligji, përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes, për të paraqitur kërkesa ose kundërshtime dhe për të ushtruar mbrojtjen përmes mbrojtësit.

14.4. Pretendimet për cenimin *e parimeve të sigurisë juridike* dhe *barazisë përpara ligjit* nuk qëndrojnë, sepse gjykatat janë shprehur për rolin e secilit kërkues në grupin kriminal, duke caktuar masa të ndryshme dënimi sipas pjesëmarrjes dhe përgjegjësive të secilit. Ky rast nuk ka të bëjë me zgjidhje të ndryshme të çështjeve gjyqësore të njëjta. Parimi i barazisë para ligjit nuk kërkon trajtim identik për çdo rast, por trajtim të njëjtë vetëm për raste faktikisht dhe juridikisht të ngjashme.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

15. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues

individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae, shterimi i mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka ngritur ndonjë prapësim.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, të dy kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të së drejtës për t'u mbrojtur, si dhe të parimeve të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit. Kërkuesi i parë ka pretenduar gjithashtu edhe cenimin e parimit të ligjshmërisë dhe të proporcionalitetit të dënimit penal.

18. Për pretendimin për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes*, kërkuesit kanë parashtruar se Prokuroria e Posaçme ka tejkaluar afatet e hetimit, ndërsa vendimet për zgjatjen e afateve, në shkelje të ligjit, në asnjë rast nuk u janë njoftuar kërkuesve, duke u hequr të drejtën për kontroll gjyqësor, ndaj ato vendime dhe aktet pasuese të tyre janë absolutisht të pavlefshme. Ky pretendim është prapësuar nga Prokuroria e Posaçme, e cila ka argumentuar se hetimet ndaj kërkuesve kanë përfunduar brenda afatit maksimal 2-vjeçar të parashikuar në pikën 2 të nenit 324 të KPP-së dhe se mosnjoftimi i vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit nuk ka pasojë mbi vlefshmërinë e akteve ose përdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton të ketë penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes ose të ketë krijuar ndonjë disavantazh procedural për kërkuesit.

19. Gjykata vëren se ky pretendim ka marrë përgjigje nga GJKKO-ja e Apelit, e cila e ka vlerësuar të pabazuar. Sipas saj, pas kalimit të akteve Prokurorisë së Posaçme në datën 18.12.2019, prokurori, me vendimet e datave 19.05.2020, 19.08.2020, 19.11.2020, 19.02.2021, 19.05.2021 dhe 19.08.2021, ka zgjatur në çdo rast afatin e hetimeve me nga tre muaj, duke respektuar afatin e veçantë tremujor dhe atë të përgjithshëm dyvjeçar, të parashikuara nga nenet 323 dhe 324 të KPP-së. Ndonëse vendimet për zgjatjen e afateve nuk u janë njoftuar kërkuesve, gjykata e apelit ka vlerësuar se kjo mangësi nuk sjell pavlefshmërinë e akteve procedurale ose papërdorshmërinë e provave të marra gjatë hetimit. Në këtë drejtim, ajo ka arsyetuar se, sipas nenit 128 të KPP-së, aktet procedurale janë të pavlefshme vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji, ndërsa neni 324 i KPP-së nuk parashikon një pasojë të tillë për mosnjoftimin e vendimit për zgjatjen e afatit. Përkundrazi, pasoja e papërdorshmërisë, e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, lidhet vetëm me provat e marra pas përfundimit të afatit të

hetimeve. Ky arsyetim është vlerësuar i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka lënë të pacenuar vendimmarrjen e gjykatës së apelit, duke mos konstatuar shkelje procedurale në procesin penal ndaj kërkuesve.

20. Për sa më lart, Gjykata çmon se argumentet e kërkuesve nuk ngrenë probleme të natyrës kushtetuese në drejtim të së drejtës së mbrojtjes, për sa kohë hetimet ndaj tyre kanë përfunduar brenda afateve të parashikuara nga ligji. Ndonëse vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit nuk u janë njoftuar kërkuesve, kjo mangësi procedurale nuk rezulton të ketë sjellë pasoja konkrete në ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes ose të ketë cenuar aksesin e tyre në gjykatë, për sa kohë pretendimet e ngritura për këtë çështje janë shqyrtuar dhe kanë marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme gjatë gjykimit të themelit. Për më tepër, vlerësimi i këtyre gjykatave nuk rezulton arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës së mbrojtjes. Për rrjedhojë, pretendimi është haptazi i pabazuar.

21. Kërkuesi i parë ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *parimit të ligjshmërisë dhe të proporcionalitetit të dënimit penal*, me argumentin se është dënuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 291 dhe 283, paragrafi i parë, të KP-së pa u kryer ekspertimet përkatëse për përcaktimin e "gjendjes nën efekt" dhe të sasisë së lëndës narkotike, duke e bërë dënimin arbitrar dhe të paparashikueshëm. Po kështu, sipas tij, në caktimin e dënimit gjykatat nuk kanë vlerësuar siç duhet rrethanat lehtësuese të parashikuara nga ligji penal.

22. Gjykata vëren se edhe ky pretendim ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme. Kështu, për veprën penale të drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se nga akti toksikologjiko-ligjor i datës 29.07.2021 ka rezultuar prania e produkteve të metabolizmit të heroinës (monoacetilmorfinë) në mostrën e urinës së marrë nga kërkuesi i parë në momentin e ndalimit. Nisur nga kjo rrethanë, si dhe nga fakti se në atë moment ai ishte duke drejtuar automjetin, gjykata ka çmuar se janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale, duke e dënuar kërkuesin e parë me 6 muaj burgim. Ndërsa për sa i përket masës së dënimit, gjykata ka argumentuar se nuk plotësohen kushtet për zbatimin e neneve 53 dhe 59 të KP-së.

23. Gjykata e apelit, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i KP-së, ka arsyetuar se kjo dispozitë, e cila parashikon dënimin me burgim nga 10 ditë deri në 3 vjet, duhet të lexohet, për efekt të zbatimit të saj, në lidhje me nenin 185, pika 1, të Kodit Rrugor. Sipas gjykatës së apelit, ky i fundit nuk përcakton një sasi të caktuar të lëndës narkotike ose psikotrope që duhet të konstatohet në organizëm për ta konsideruar drejtuesin e mjetit nën efektin e saj, pasi ndalimi i drejtimit të mjetit pas përdorimit të këtyre lëndëve është kategorik, pavarësisht sasisë së konstatuar.

24. Për sa i takon mungesës së ekspertimit për përcaktimin e sasisë së lëndës narkotike dhe vlerësimin nëse ajo përbënte dozë të vogël për përdorim vetjak, gjykata e apelit, duke iu

referuar vendimit unifikues nr. 1/2008, ka çmuar se mungesa e këtij ekspertimi nuk e përjashtonte kërkuesin e parë nga përgjegjësia penale. Në këtë përfundim ajo ka arritur duke vlerësuar në tërësi provat dhe rrethanat e çështjes, përfshirë mënyrën e fshehjes së lëndës në pjesët intime të trupit, tentativën për ta hedhur atë gjatë shoqërimit, si dhe sasinë prej 4.084 gramësh heroinë, e cila nuk ishte e ndarë në doza të vogla dhe, sipas gjykatës, nuk mund të konsiderohej, në pamje të parë, sasi e vogël.

25. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit të parë, sikurse me të drejtë ka prapësuar edhe Prokuroria e Posaçme, nuk qëndron. Çështja e mungesës së akteve të ekspertimit për përcaktimin e "gjendjes nën efekt" dhe të sasisë së lëndës narkotike i është nënshtruar vlerësimit të gjykatave të zakonshme, të cilat, referuar tërësisë së provave dhe rrethanave të çështjes, kanë arsyetuar se kjo mungesë nuk e përjashtonte kërkuesin nga përgjegjësia penale. Në këtë vlerësim ato kanë mbajtur në konsideratë, ndër të tjera, rezultatet e aktit toksikologjiko-ligjor, sasinë dhe mënyrën e mbajtjes së lëndës narkotike, si dhe sjelljen e kërkuesit gjatë shoqërimit. Po kështu, për sa i përket proporcionalitetit të dënimit, kërkuesi i parë është dënuar me 6 muaj burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i KP-së, për të cilën ligji parashikon dënim deri në 3 vjet burgim, dhe me 5 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë, i KP-së, për të cilën parashikohet dënimi deri në 10 vjet burgim. Gjykatat kanë arsyetuar edhe për mosplotësimin e kushteve për zbatimin e dispozitave që lejojnë uljen e dënimit. Në këto rrethana, vlerësimi i gjykatave të zakonshme, si për përgjegjësinë penale, ashtu edhe për individualizimin e masës së dënimit, nuk rezulton arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm që të ngrejë çështje të natyrës kushtetuese. Për rrjedhojë, pretendimi është haptazi i pabazuar.

26. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe të *parimeve të sigurisë juridike* dhe *të barazisë përpara ligjit,* kërkuesit kanë parashtruar se nuk kanë marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimin e tyre lidhur me cilësimin e gabuar juridik të veprave penale. Sipas tyre, ata janë dënuar për kryerjen e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, ndonëse, për të njëjtat episode kriminale, dy bashkëpunëtorë të tjerë ishin dënuar më parë në formën e bashkëpunimit të thjeshtë. Për sa kohë kërkuesit pretendojnë se një shkak me natyrë kushtetuese, i ngritur në rekurse, ka mbetur pa përgjigje dhe duke mbajtur në konsideratë se Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel, por ka vendosur mospranimin e rekurseve, Gjykata do t'i analizojë pretendimet e tyre në këndvështrim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

27. Kërkuesit kanë pretenduar se megjithëse në rekurse kishin ngritur pretendime për shkelje procedurale, që kishin ndikuar në të drejtat kushtetuese të tyre, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve, duke mos u dhënë përgjigje. Për më tepër, sipas kërkuesit të dytë, vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, sepse, nga njëra anë, shprehet se pretendimet në rekurse kanë të bëjnë me shkelje procedurale, ndërsa, nga ana tjetër, arrin në përfundimin se pretendimet kanë të bëjnë me provat.

28. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë është i arsyetuar nga pikëpamja kushtetuese dhe se fakti që ajo gjykatë ka mbështetur argumentet e dhëna nga gjykatat e posaçme, nuk përbën shkelje të standardit të arsyetimit të vendimit. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat e posaçme u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurse, duke i vlerësuar ato shteruese dhe në përputhje me ligjin procedural penal.

29. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë. Ndërsa neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit, si pjesë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. E drejta e aksesit përfshin edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyetuar. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), në kuadër të parimit të subsidiaritetit, Gjykata e Lartë duhet të investohet në ekzaminimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht në një proces penal që ka përfunduar me dënim me burgim, gjykata më e lartë nuk mund të kufizohet

në përdorimin e formulimeve të përgjithshme ose standarde dhe ajo duhet të tregojë, së paku, se i ka identifikuar pretendimet dhe se i ka shqyrtuar ato në mënyrë reale (*shih vendimin nr. 74, datë 16.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nga ana tjetër, Gjykata është shprehur se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjykata, në respekt të parimit të subsidiaritetit dhe të kufijve ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe atij të gjykatave të zakonshme, do të analizojë nëse vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekurseve përmbush standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për këtë qëllim, ajo do të verifikojë nëse arsyetimi i kufizuar i këtij vendimi, i lexuar së bashku me shkaqet e rekurseve dhe arsyetimin e gjykatave të faktit, mbështet disponimin për mospranimin e rekurseve, si dhe nëse kërkuesit kanë marrë përgjigje efektive për pretendimin e tyre për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në përputhje me garancitë e nenit 42 të Kushtetutës.

34. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se kërkuesit janë akuzuar se kanë organizuar në të paktën tre raste trafikim të lëndëve narkotike nga Shqipëria drejt Greqisë në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Lidhur me këto episode, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin e datës 27.10.2022, ka deklaruar fajtor kërkuesin e parë për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, paragrafi i dytë, 28, paragrafi i katërt, 333/a, paragrafi i parë, 334, paragrafi i parë, 283, paragrafi i parë dhe 291 të KP-së, duke e dënuar përfundimisht me 12 vjet burgim dhe kërkuesin e dytë për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, paragrafi i dytë, 28, paragrafi i katërt, 333/a, paragrafi i parë dhe 334, paragrafi i parë, të KP-së, duke e dënuar përfundimisht me 10 vjet burgim.

35. Lidhur me ekzistencën e bashkëpunimit në formën e grupit të strukturuar kriminal, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka argumentuar se në rastin konkret bashkëpunimi ka qenë me persona që kanë pasur si qëllim të vetëm trafikimin e lëndëve narkotike; ai nuk ka qenë rastësor, por i shtrirë në kohë dhe është ndërprerë për shkak të ndërhyrjes së forcave të policisë; rrjedhshmëria e veprimeve dëshmon se ky aktivitet i ka fillesat shumë më të hershme; kërkuesit kanë pasur role të përcaktuara; edhe pse nuk është provuar koha kur është krijuar grupi kriminal, rezulton e provuar se ka një vazhdimësi kohore; krimi është serioz; formësimi i grupit nuk është i rastësishëm, ata vepronin sipas një strukture të qëndrueshme dhe ekzistonte një hierarki me pozicionet e tyre dhe rolet e secilit lidhur me organizimin, gjetjen dhe transportimin e lëndës narkotike (*shih vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqet 72-74*).

36. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur apel kërkuesit, duke pretenduar, ndër të tjera, zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal në drejtim të cilësimit juridik të veprës penale. Sipas tyre, për të njëjta subjekte, të njëjtin aktivitet dhe për të njëjtin fakt penal është dhënë cilësim i ndryshëm juridik, pasi në dy prej episodeve, dy prej bashkëpunëtorëve të tyre, ndonëse kanë marrë pjesë në të njëjtat ngjarje dhe veprimet e tyre kanë qenë pjesë e të njëjtës veprimtari të trafikimit të lëndëve narkotike, janë dënuar për veprën penale të trafikimit në bashkëpunim të thjeshtë, pa iu atribuar edhe figura e veprës penale të grupit të strukturuar kriminal, sikurse ka ndodhur me ta.

37. GJKKO-ja e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, duke vlerësuar të drejtë cilësimin juridik të veprave penale dhe individualizimin e dënimeve për kërkuesit. Ajo ka arsyetuar se kërkuesit kanë konsumuar veprën penale të grupit të strukturuar kriminal, pasi veprimtaria e tyre e trafikimit të lëndëve narkotike nga Shqipëria drejt Greqisë është kryer në kuadër të një grupi të tillë. Sipas saj, kërkuesit kanë pasur cilësinë e drejtuesve të grupit të strukturuar kriminal që merrej me trafikimin e lëndëve narkotike, çka është provuar nga qëndrueshmëria në kohë e veprimtarisë së tyre, e evidentuar në tri episodet e datave 25.05.2016, 12.06.2016 dhe 10.12.2016, si dhe në episode të tjera të ndjekura penalisht nga autoritetet greke të drejtësisë.

38. GJKKO-ja e Apelit është shprehur se, ndonëse nga përmbajtja e dy vendimeve të tjera të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, të dhëna në vitet 2017 dhe 2018, rezulton se bëhet fjalë për të njëjtin fakt penal në dy prej episodeve (episodi i dytë i datës 12.06.2016 dhe episodi i tretë i datës 10.12.2016), kjo nuk pengon një cilësim juridik të ndryshëm të faktit, për sa kohë ndaj kërkuesve nuk rezulton të jetë ngritur më parë akuzë dhe ata të jenë gjykuar për të. Sipas saj, cilësimi juridik i faktit penal në dy vendimet e mëparshme, ndonëse ato kanë marrë formë të prerë, nuk është detyrues për trupin gjykues që shqyrton çështjen konkrete. Për rrjedhojë, cilësimi juridik i ndryshëm i të njëjtave fakte penale në çështjen në shqyrtim dhe në vendimet e mëparshme nuk përbën, në vetvete, cenim të standardeve të procesit të rregullt ligjor, përfundim që, sipas gjykatës së apelit, buron edhe nga parimi i pavarësisë së gjykatës. Gjithsesi, sipas saj, kontradikta ndërmjet këtyre vendimeve dhe atij të dhënë në përfundim të gjykimit të çështjes konkrete mund të zgjidhet përmes një mjeti të jashtëzakonshëm ankimi, sikurse është kërkesa për rishikim (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, paragrafët 174–175*).

39. Ky arsyetim i gjykatës së apelit është kundërshtuar nga kërkuesit në shkaqet e rekurseve. Ata kanë pretenduar sërish se të njëjtit fakt penal, të vërtetuar tashmë me vendim gjyqësor të formës së prerë si trafikim i kryer në formën e bashkëpunimit të thjeshtë, në rastin e tyre i është dhënë një cilësim i ndryshëm juridik, duke u konsideruar si aktivitet i kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal.

40. Megjithatë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuesve. Sipas saj, GJKKO-ja e Apelit i ka shqyrtuar të gjitha shkaqet e ngritura në ankim, në të cilin ata nuk kanë paraqitur pretendime lidhur me ekzistencën e faktit penal, por vetëm kërkime që lidhen me cilësimin juridik të këtij fakti, si dhe pretendime për shkelje të natyrës procedurale (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafi 25*). Po sipas Gjykatës së Lartë, shkaqet e rekurseve kanë të bëjnë vetëm me çështjen e provave dhe nuk referojnë në shkelje të ligjit penal material e procedural, si dhe nuk konstatohen shkelje ose zbatim i gabuar i ligjit penal procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit (*shih po aty, paragrafët 26 dhe 27*).

41. Nga analiza e arsyetimit të këtyre vendimeve, Gjykata vëren, *së pari*, se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve, duke arsyetuar se pretendimet e ngritura në to lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural, pasi kanë të bëjnë me cilësimin juridik të veprës penale dhe shkelje të tjera procedurale, për të cilat GJKKO-ja e Apelit ka dhënë përgjigje të argumentuar. Nga ana tjetër, ajo ka arsyetuar se këto pretendime kanë të bëjnë vetëm me çështje të vlerësimit të provave dhe, për rrjedhojë, nuk përfshihen në shkaqet e rekursit të parashikuara nga ligji procedural penal. Në këtë mënyrë, argumentet e pjesës arsyetuese të vendimit nuk janë koherente me njëra-tjetrën dhe, për pasojë, nuk mbështesin, nga pikëpamja kushtetuese, disponimin për mospranimin e rekurseve, duke cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

42. *Së dyti*, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka mbështetur arsyetimin e GJKKO-së së Apelit, duke e vlerësuar atë të bazuar në ligj edhe për sa i takon rrëzimit të pretendimit të kërkuesve për cilësimin juridik të faktit penal. Për rrëzimin e këtij pretendimi, GJKKO-ja e Apelit është mbështetur në dy argumente: (i) në parimin e pavarësisë së gjyqtarit; (ii) në mundësinë e kërkuesve për të përdorur mjetin e jashtëzakonshëm të rishikimit pas përfundimit të gjykimit.

43. Për sa i përket argumentit të parë, Gjykata sjell në vëmendje se neni 145 i Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, sanksionon parimin e pavarësisë së brendshme të gjyqtarit në ushtrimin e funksionit të tij. Në kuptim të kësaj pavarësie, gjyqtari i zakonshëm, në zbatimin e një dispozite ligjore për një çështje konkrete, i jep asaj interpretimin dhe kuptimin e tij sipas fakteve që shqyrton. Megjithatë, kjo pavarësi ushtrohet brenda kufijve që burojnë nga rendi juridik, ndër të cilët është edhe detyrimi për të respektuar autoritetin e gjësë së gjykuar (*res judicata*). Gjykata ka theksuar se në aspektin formal e procedural gjë e gjykuar nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë detyruese të vendimit *(shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese).* Për rrjedhojë, kur një çështje është zgjidhur përfundimisht dhe përmbushen kushtet për zbatimin e këtij parimi, pavarësia në interpretimin dhe zbatimin e ligjit

nuk mund të shërbejë për të rishqyrtuar atë që është vendosur përfundimisht. Në këtë kuptim, një vendim gjyqësor përfundimtar, me të cilin është cilësuar juridikisht një fakt penal, duhet të merret në konsideratë nga gjykata që shqyrton të njëjtin fakt në një proces tjetër, për aq sa shtrihen efektet e gjësë së gjykuar.

44. Parë nga kjo optikë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë nuk mund të vendoste mospranimin e rekurseve të kërkuesve. Në ndryshim nga sa ka vlerësuar Gjykata e Lartë, çështja në rastin konkret nuk lidhej me pavarësinë e gjyqtarit në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, por me detyrimin për të shqyrtuar në mënyrë efektive pretendimin e kërkuesve për ekzistencën e dy cilësimeve juridike të ndryshme për të njëjtin fakt penal dhe pasojat juridike që rridhnin prej tyre.

45. Po ashtu, Gjykata çmon se as argumenti i dytë i gjykatës së apelit, sipas të cilit kontradikta ndërmjet vendimeve mund të zgjidhej nëpërmjet kërkesës për rishikim pas përfundimit të gjykimit, nuk është në përputhje me kërkesat kushtetuese për një mjet ankimi efektiv. Kur individi ushtron një mjet të zakonshëm ankimi, sikurse është apeli, gjykata duhet t'i japë përgjigje efektive pretendimit të ngritur rregullisht përpara saj dhe nuk mund ta orientojë atë drejt një mjeti të jashtëzakonshëm ankimi, sikurse është rishikimi, i cili mund të ushtrohet vetëm pas përfundimit të procesit dhe bërjes përfundimtare të vendimmarrjes. Një qasje e tillë e shtyn shqyrtimin e pretendimit përtej procesit në të cilin ai është ngritur dhe, për rrjedhojë, nuk garanton efektivitetin e ankimit të ushtruar. Për më tepër, në kohën kur kërkuesit kanë ngritur këtë pretendim, çështja ishte ende në gjykim dhe vendimmarrja nuk ishte bërë përfundimtare për efekt të rishikimit. Në këto rrethana, Gjykata e Lartë kishte detyrimin t'u garantonte kërkuesve shqyrtimin substancial të pretendimit të tyre.

46. Nevoja për shqyrtimin efektiv të këtij pretendimi përforcohet edhe nga dispozitat e KPP-së, të cilat, në funksion të sigurisë juridike, synojnë, ndër të tjera, të sigurojnë koherencën në shqyrtimin dhe vlerësimin e të njëjtave fakte penale. Kështu, kodi parashikon mundësinë e bashkimit të procedimeve kur vepra penale është kryer nga disa persona në bashkëpunim ndërmjet tyre (neni 79), ndërsa ndarja e çështjeve, edhe kryesisht, lejohet vetëm kur nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve (neni 93). Po kështu, vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të merren për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, duke u vlerësuar në unitet me provat e tjera (neni 193, pika 7).

47. Detyrimi për t'i dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesve lidhet edhe me funksionin e Gjykatës së Lartë për të siguruar koherencën e praktikës gjyqësore dhe për të shmangur kontradiktat për të cilat vihet në dijeni gjatë shqyrtimit të çështjeve konkrete. Edhe pse qëndrimet e ndryshme të gjykatave të faktit në interpretimin dhe zbatimin e ligjit janë të mundshme, Gjykatës së Lartë, si gjykata më e lartë në vend, i takon të korrigjojë interpretimet kontradiktore dhe të shmangë pasigurinë juridike që mund të cenojë të drejtën për proces të

rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se, ndonëse jurisprudenca kontradiktore është e natyrshme në një sistem gjyqësor të përbërë nga një sërë gjykatash më të ulëta, roli i gjykatës më të lartë është pikërisht zgjidhja e kontradiktave të tilla. Ekzistenca e gjykatës më të lartë mundëson korrigjimin e interpretimeve kontradiktore dhe harmonizimin e jurisprudencës, duke shmangur pasigurinë e vazhdueshme juridike që mund të cenojë garancitë e gjykimit të drejtë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së (*shih Iordan Iordanov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, 02.07.2009, §§ 47-48, 53*).

48. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe e ka bërë aksesin e kërkuesve thjesht formal dhe jo substancial. Kjo ka sjellë cenimin e së drejtës së kërkuesve për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

49. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkimet e kërkuesve janë pjesërisht të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-1003, datë 12.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.09.2026

Shpallur më 09.10.2026

MENDIM PAKICE

1. Unë gjyqtari Asim Vokshi, pas shqyrtimit nga Gjykata të çështjes që i përket kërkesës së kërkuesve Irfan *alias* Stefan Sulaj dhe Dëfrim *alias* Afrim Çela *alias* Çelaj, me objekt "Shfuqizimi i vendimeve nr. 62, datë 27.10.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 26 (87-2023-103), datë 17.05.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1003, datë 12.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë gjykatës kompetente", jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, pasi gjeti cenim të së drejtës së aksesit substancial në gjykatë në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, veçanërisht për sa i përket arsyetimit të detajuar të munguar të Gjykatës së Lartë në lidhje me veprimin e parimit të gjësë së gjykuar dhe arsyetimit kontradiktor të GJKKO-së së Apelit.

3. Pakica vlerëson se në këtë çështje shtrohet për diskutim kushtetutshmëria e kualifikimit (cilësimit) të ndryshëm të grupit të fakteve penale (tre episode) për kërkuesit në raport me dy bashkëpunëtorë të tjerë të tyre që janë dënuar më parë secili më vete për nga një episod nga tre episodet penale, jo në kuadër të grupit të strukturuar kriminal si kërkuesit, por me bashkëpunim të thjeshtë. Interpretimi ligjor i fakteve, sidomos kur ato nuk janë identike, është veprimtari gjyqësore që nuk mund t'i nënshtrohet gjykimit kushtetues për sa kohë nuk ka passjellë cenimin e ndonjë të drejte themelore të garantuar nga Kushtetuta. Në këtë kontekst, pajtohem me qëndrimin e shumicës, i cili, si rregull, përbën një standard shumë të mirë, se Gjykata Kushtetuese kur vlerëson kushtetutshmërinë e vendimeve të Gjykatës së Lartë, me të cilat është vendosur mospranimi i rekursit, sheh "*nëse arsyetimi i kufizuar i këtij vendimi, i lexuar së bashku me shkaqet e rekurseve dhe arsyetimin e gjykatave të faktit, mbështet disponimin për mospranimin e rekurseve, si dhe nëse kërkuesit kanë marrë përgjigje efektive për pretendimin e tyre për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në përputhje me garancitë e nenit 42 të Kushtetutës*". Veçse nëse shihet arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë që në vetvete ka pranuar arsyetimin e GJKKO-së së Apelit, si dhe shkaqet e parashtruara në rekurs në raport me arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit, arrij në përfundimin se nuk ka shkelje të ndonjë të drejte kushtetuese të kërkuesve.

4. Thelbi i parashtrimeve të kërkuesve, tek i cili u ndal shumica në arsyetimin e vet, lidhet me mungesën e arsyetimit të Gjykatës së Lartë në lidhje me efektet e gjësë së gjykuar në çështjen objekt shqyrtimi para saj. Gjëja e gjykuar universalisht gjen zbatim kur dy çështje janë të njëjta për sa u përket palëve, objektit dhe shkakut. Nëse një nga këto elemente mungon, nuk

mund të flitet për gjë të gjykuar. Kjo pasi faktet mund të kualifikohen ligjërisht sipas normave të ndryshme penale, sidomos kur përfshihen në grupfakte që në vetvete ndryshojnë rrethanat faktike të çështjes. Vetë Gjykata pranon se dy bashkëpunëtorë të tjerë të kërkuesve janë gjykuar dhe dënuar për bashkëpunim, secili për nga një episod të veçantë të trafikimit të narkotikëve. Ndërkohë që ata nuk janë gjykuar edhe për episodin e datës 25.05.2016, që përbën fakt shtesë në lidhje me akuzën ndaj kërkuesve. Edhe pa e thënë gjykatat e zakonshme, kjo është evidente, se passjell ndryshim të faktit penal për këta kërkues, i cili natyrisht mund të shoqërohet edhe me kualifikim të ndryshëm penal, në respekt të parimit të ligjshmërisë dhe pavarësisë së gjykatës që shqyrton çështjen. Aq më tepër që GJKKO-ja e Apelit, siç theksohet në paragrafin 37 të vendimit të Gjykatës, ka arsyetuar se "kërkuesit kanë pasur cilësinë e drejtuesve të grupit të strukturuar kriminal që merrej me trafikimin e lëndëve narkotike, çka është provuar nga qëndrueshmëria në kohë e veprimtarisë së tyre, e evidentuar në tre episodet e datave 25.05.2016, 12.06.2016 dhe 10.12.2016, si dhe në episode të tjera të ndjekura penalisht nga autoritetet greke të drejtësisë." Pra, jo vetëm episodi ekstra i datës 25.05.2016, por edhe episode të tjera të ndjekura penalisht nga autoritetet greke të drejtësisë kanë qenë pjesë e grupfakteve që kanë krijuar bindjen e gjykatës për cilësimin juridik të tyre në kuadër të grupit të strukturuar kriminal.

5. Shumica ka gjetur jokoherent arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, pasi ajo ka theksuar se për sa i përket cilësimit juridik të fakteve vlen arsyetimi i GJKKO-së së Apelit, ndërsa pretendimet e kërkuesve për çështjet e vlerësimit të provave nuk përfshihen brenda shkaqeve për të cilat lejohet rekurs. Mendoj se e kundërta e jokoherencës është e vërtetë, pasi tjetër gjë është cilësimi juridik i fakteve (që përfshihet në kompetencën njësuese të Gjykatës së Lartë) dhe tjetër gjë është ngritja e pretendimeve për themelësinë, vërtetësinë, si dhe saktësinë e fakteve mbi të cilat është dhënë vendimi i dënimit. Këto të fundit nuk janë në kompetencën e Gjykatës së Lartë, por vetëm të gjykatave të faktit. Ndaj formula e përdorur nga Gjykata e Lartë nuk paraqitet jokoherente, pasi u referohet dy anëve të ndryshme të shqyrtimit të rekurseve në atë gjykatë. Çështjet e ligjit i përkasin Gjykatës së Lartë, ndërsa çështjet e faktit jo. Thënë ndryshe, Gjykata e Lartë mund të bënte të vetin arsyetimin e drejtë të GJKKO-së së Apelit për çështjet e ligjit, por për sa i përket vlerësimit faktik nëse episodet kriminale ishin provuar ose jo, apo si qëndronin ato si fakte, ajo gjykatë nuk kishte tagra gjykimi.

6. Gjykata e Lartë, duke pranuar arsyetimin e GJKKO-së së Apelit për sa i përket mosndikimit të vendimeve penale të dënimit për dy bashkëpunëtorët e gjykuar veçmas, ka respektuar parimin e pavarësisë së gjykatës për kualifikimin juridik të veprës penale dhe formën e bashkëpunimit bazuar mbi konstatimin e fakteve të tjera, të ndryshme nga ato të konstatuara nga gjykatat në procesin ndaj bashkëpunëtorëve. Çmuarja fillestare e fakteve nga një gjykatë konform nenit 152, pika 1, të KPP-së nuk përbën "fakt të papajtueshëm" për

çmuarjen e grupfakteve të tjera (ku mund të përfshihen edhe disa nga faktet e shqyrtuara nga gjykata e parë) që një gjykatë tjetër do të bëjë për to, kur shqyrton çështjen penale të veçuar për bashkëpunëtorin tjetër. Këtu nuk vepron koncepti i gjësë së gjykuar. Nëse do të pranohej e kundërta, atëherë do të rrezikohej të lihej pa zbatim parimi i pavarësisë së gjykatës në gjykimin e çështjes të parashikuar nga neni 3, pika 2, i KPP-së, sipas të cilit: "Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen e verifikohen në seancë gjyqësore.". Në këtë prizëm ka qenë edhe argumenti i GJKKO-së së Apelit në lidhje me mundësinë e përdorimit të mjetit të rishikimit, jo se ajo gjykatë ka konstatuar se ekzistonte rasti i rishikimit, por se nëse faktet do të ishin të njëjta, pala do të kishte edhe atë mundësi kundërshtimi. Ky argument shtesë i GJKKO-së së Apelit është i parëndësishëm për rastin konkret dhe nuk rezulton se është dhënë në kontekstin se faktet që qëndronin në bazë të vendimeve të dënimit të bashkëpunëtorëve ishin të papajtueshme me faktet për të cilat po gjykoheshin kërkuesit. Nëse do të ishte ky rasti, shumica ka vlerësuar drejt kur shprehet se arsyetimi i GJKKO-së së Apelit se "kontradikta ndërmjet vendimeve mund të zgjidhej nëpërmjet kërkesës për rishikim pas përfundimit të gjykimit", nuk është në përputhje me kërkesat kushtetuese për një mjet ankimi efektiv. Cilësimet juridike të ndryshme për të njëjtin fakt penal nuk përbëjnë shkak për rishikim të vendimit penal të dytë, sipas nenit 450, pika 1, shkronja "a", të KKP-së, aq më tepër kur del qartë se faktet, si në rastin e kërkuesve, ishin të ndryshme për sa i përket episodit të datës 25.05.2016 dhe episodeve të tjera të ndjekura penalisht nga autoritetet greke të drejtësisë. Ligji procedural penal nuk ka parashikuar se gjykata e dytë që shqyrton veçmas akuzën ndaj një bashkëpunëtori është e lidhur me cilësimin juridik që u është bërë fakteve ose episodeve penale për të cilat është gjykuar më vete më parë një bashkëpunëtor tjetër, ose me formën dhe shkallën e bashkëpunimit. Nëse do të pranohej kjo, atëherë gjykata penale që zgjidh e para një çështje penale ndaj një bashkëpunëtori (p.sh: sepse çështja veçohet për shkak të zbatimit të gjykimit të shkurtuar), praktikisht ka zgjidhur edhe çështjet e tjera ndaj bashkëpunëtorëve të tjerë, të cilat gjykohen me procedurën e zakonshme. Vlerësimi i ekzistencës ose jo të grupit të strukturuar kriminal, si pjesë e cilësimit ligjor të bashkëpunimit, hyn brenda kuptimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, e cila i vlerëson vetë faktet penale, për sa kohë që nuk gjen zbatim koncepti i gjësë së gjykuar.

7. Ndaj jam i mendimit, të mbetur në pakicë, se në këtë rast Gjykata e Lartë, për aq sa i është pretenduar në rekurs, e ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e vet dhe nuk kishte vend për cenimin e kësaj vendimmarrjeje. Vlerësoj se jo çdo pasaktësi ose mangësi e arsyetimit të gjykatave të zakonshme duhet të përbëjë shkak për cenimin e tyre në gjykimin kushtetues, por vetëm ato gabime që janë të papajtueshme me rendin juridik kushtetues. Vlerësimi nga gjykatat e zakonshme për faktet dhe ligjin e zbatueshëm për to, për sa kohë që dukshëm nuk prek thelbin e të drejtave themelore të kërkuesve, nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimmarrjeve.

Gjykata Kushtetuese nevojitet t'u njohë gjykatave të zakonshme hapësirën e gjerë që u njeh Kushtetuta për zgjidhjen e çështjeve, sipas parimit të pavarësisë dhe paanësisë që gjykatat duhet të kenë dhe të ndërhyjë vetëm në raste të izoluara kur vendimmarrja është aq e pakujdesshme sa një gjykatë normalisht nuk do ta merrte atë. Barra e të pretenduarit për kërkuesit në gjykimin kushtetues është tepër e lartë, sepse gjykimi kushtetues nuk është dizenjuar për të rigjykuar çështjen, por vetëm për të shmangur ato raste sporadike, kur gjykatat dukshëm nuk e kanë bërë punën e tyre sipas parimeve kushtetuese. Në ankimin kushtetues individual kërkuesit nuk më rezulton se kanë argumentuar bindshëm që t'u jetë cenuar ndonjë e drejtë kushtetuese nga kjo vendimmarrje, ndaj kërkesa duhej të rrëzohej.

Anëtar : Asim Vokshi